

Bachelor në **Inxhinieri Ndërtimi** (180 ECTC, 3 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional

Qëllimi i Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është që të përgatisë studentët profesionalisht si Inxhiniera Ndërtimi, për të marrë një rol kyç që në fazat e para të projektimit dhe në vijim në bashkërendimin e gjithë proceseve të ndërtimit dhe zbatimit. Në këtë mënyrë, studenti duhet të zotërojë aftësi planifikimi, organizimi, mbikëqyrjeje dhe koordinimi të aktorëve dhe elementëve të nevojshëm në procesin e ndërtimit si zhvilluesit, nënkontraktorët, konsulentët, projektuesit, zbatuesit, financat, materialet, etj. Për të bërë të mundur këtë nevojitet një edukim i bazuar në një spektër dijesh të gjerë në fushat jo vetëm shkencore e teknologjike por dhe të menaxhimit. Ky program synon të sigurojë studentët me aftësitë e duhura teknike dhe të menaxhimit të procesit të ndërtimit në mënyrë efektive për të kontribuar në këtë mjedis dhe të përgatisë studentët për karrierën e tyre si inxhinier por dhe si kërkues të ardhshëm.

Temat kryesore që trajton ky program studimi:

- *Formim i përgjithshëm*
- Analizë Matematike; Fizike; Kimi; Algjebër dhe Gjeometri; Gjeometri deskriptive.
- *Formim baze karakterizues*
- Mekanika e strukturave; Teori Strukturash; Statikë; Gjeodezi Inxhinierike; Konstruksione Metalike; Konstruksione B/A; Teknologji Ndërtimi; Konstruksione prej Betoni të Parandëruar etj.
- *Formim integruar*
- Hidraulikë; Impiantistike; Furnizim me Ujë; Fizikë Teknike

Mundësitë për punësim

Sektorët kryesorë të punësimit përfshijnë:

- Sektori privat: sipërmarrje projektimi dhe ndërtimi arkitektonik e inxhinierik, firma konsulence, kontraktorë, studio të projektimit inxhinierik dhe arkitektonik.
- sektori i shërbimeve dhe prodhimit industrial në fushën e ndërtimit (materialet, pajisje, etj.), fushën e zbatimit
- Sektori publik: autoritete lokale apo agjencive qeveritare; në nivelet e ndryshme të qeverisjes; duke filluar që nga bashkitë e komunat e deri tek qarku apo rajonet;

Plani Mësimor si më poshtë vijon:

Plan Mësimor sipas tipeve të veprimtarive i programit të studimit

Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi

Fusha disiplinore	Veprimtari formuese	Kredite	Kredite total	Kredite (%)
A (formim bazë i përgjithshëm)	Fizikë 1	6	45	25%
	Analizë Matematike	9		
	Algjebër dhe Gjeometri	6		
	Fizikë 2	6		
	Geometri Deskriptive	12		
	Kimi	6		
B (karakterizuese)	Materiale Ndërtimi	6	84	47%
	Ekonomi / Kantier Ndërtimi	3		
	Mekanika e strukturave	6		
	Statika e strukturave	6		
	Rezistencë Materialesh	6		
	Gjeologji Inxhinierike	6		
	Teori Strukturash	6		
	Gjeoteknikë I (Mekanike Dherash)	6		
	Gjeodezi Inxhinierike	3		
	Gjeoteknikë II (Inxhinieri Themelesh)	6		
	Konstruksione B/A	6		
	Konstruksione Metalike	6		
	Teknologji Ndërtimi I	6		
	Teknologji Ndërtimi II	6		
	Konstruksione Muri dhe Guri	3		
Konstruksione prej Betoni te Paranderur	3			
C (integruese)	Rrjete Teknologjike - Furnizim me Uje	3	15	8%
	Hidraulikë	6		
	Impiantistikë	3		
	Fizikë Teknike	3		
D (me përzgjedhje)	Lëndë me përzgjedhje 1	6	12	7%
	Lëndë me përzgjedhje 2	3		
	Lëndë me përzgjedhje 3	3		
E (formuese plotësuese)	CAD I	3	18	10%
	Ligji dhe Legjislacioni Urban	6		
	Anglisht dhe Shkrim Akademik	3		
	Internship Profesional	6		
F (teza e diplomës)	Teza dhe Projekt Diploma	6	6	3%
	TOTAL	180	180	100%